

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - PUNE

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Kalim nga 10 ne 20 kv rrjeti TM, rikonstruksion i kabinave dhe rrjeti TU me kabell ABC, ne fiderin F-16 (Shengjin kabllor), N/St Lezhe”

KODI CPV : 09310000-5 - Eletricitet

VLERA E FONDIT LIMIT:

77 042 572, 72 (Shatedhjete e shtaet milion e dyzet e dy mije e peseqind e shtatedhjete e dy pike shtatedhjete e dy) leke pa TVSH

Ndarje ne Lote - NUK KA

Proedura e prokurimit nuk eshte ndare ne Lote, pasi ne si Autoritet Kontraktor e kemi vleresuar se kjo procedure nuk mund te ndahet ne Lote. Kjo per arsye se delegimi dhe autorizimi per realizmin e procedures se prokurimit qe na eshte dhene nga Administratori OSSH sh.a Tirane nuk na eshte dhene i ndare ne Lote. Kemi te bejme me procedure pune dhe puna do te realizohet ne nje fider te vetem.

Në bazë të nenit 21, pika 2, dhe 49 të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, dhe nenit 41 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,autoriteti/enti kontraktor Drejtoria Rajonale e OSSH Shkoder ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës ...;

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Përmiratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen me Nenin⁷⁶ "Kriteret detyruese përskualifikim" Nenin 82 "Formulari përmbledhës i vetdeklarimit" dhe Neni 83 "Sigurimi i ofertës", të Ligjit Nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik" si dhe në mbështetje të Nenit 26 "Formulari përmbledhës i vetdeklarimit" dhe nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik:

Neni 82, i Ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin publik"

1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prova paraprake në vend të disa vertetimeve të leshuara nga autoritetet publike ose pale të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik".

Neni 83, i Ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin publik"

"Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël",

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Liçensa profesionale lidhur me ekzekutimin e punëve të Kontrates.

a. License profesionale sipas modelit të leshuar MPPT e Shoqërisë e vlefshme me kategorite:

NP -1 Punime gërmimi në tokë , Klasifikimi i shoqërisë A,

NP -4 Rruge, Autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista autoportuale, Klasifikimi i shoqërisë A

NP -11 Ndërtime për nënstacionet, kabinat e transformatorët linja e tension të Lartë e të mesëm të shpërndarjes së energjisë elektrike, Klasifikimi i shoqërisë B

NP -12 Punime të inxhinierisë së mjedisit, Klasifikimi i shoqërisë A

NS-6 Sinjalistika rrugore jo ndricuese, Klasifikimi i shoqërisë A

NS-14 Impiante të brendshme elektrike, Klasifikimi i shoqërisë A

NS-18 Punime topogjeodezie Niveli i Shoqërisë A,

Për Operatorët e huaj të bëhet njehsimi i licencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.

c. Kandidati ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) Drejtuesin Teknik ose Drejtuesit Teknik të punimeve në objekt, të përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se do të jenë të pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, si dhe një deklaratë nga vetë drejtuesi teknik që është dakort të jete I angazhuar në mënyrë të vazhdueshme për nevojat e institucionit, shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm:

- i. CV përkatëse
- ii. Kontratë pune e vlefshme (përkatëse)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 41, pika 4/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Institucioni ynë kërkon si kusht për nevojat e subjektit që të ketë këto pika licence dhe drejtuesin teknikë për të realizuar shërbimin në cilësi shumë të mirë.

- Xhiroja mesatare vjetore e vitit, 2020, 2021 dhe 2022 duhet të ketë një vlerë të kërkuar mesterisht për këto tre vite jo më të ulët se 50 % të vlerës së fondit limit. *Per këto të paraqitet Vertetim nga Administrata Tatimore (Në formë elektronike).*
- Kopje të certifikuara nga organet tatimore të bilanceve pozitive për vitin 2020, 2021, 2022 të paraqitura dhe të konfirmuara nga autoritetet përkatëse;

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në Ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

Kërkesa për paraqitjen e bilanceve është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë.

Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të bilanceve, të certifikuara nga autoritetet përkatëse (Dega e Tatim Taksave) për tre vitet e fundit ku të paktën në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi:Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen rastet kur personat juridikë kanë detyrimin që të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese).

2.3.1 Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:

II. Punë të ngjashme për një object të vetëm në një vlerë jo me te ulet se 50% e vlerës së përlloritur të fondit limit dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, ose, punë të ngjashme të realizuara gjatë tre viteve të fundit ne jo me pak se dyfishin e fondit limit që prokurohet; Plotesimi i njerit prej dy kushteve të siperpermendura e ben oferten të kualifikueshme Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:

Për kontrata të realizuara meente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin emëposhtëm:

Formularin e Vleresimit, shoqëruar me:

Kontratë Siper marrje

Situacionin përfundimtar;

Aktin e kolaudimit;

Faturat perkatese tatimore e situacionit përfundimtar

Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

Formularin e Vleresimit, shoqëruar me:

Kontrate;

Situacionin përfundimtar;

Akt kolaudimi objekti;

Fatura tatimore per cdo situacion punimesh ose per situacionin perfundimtar

Pika 1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata te ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat 50 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, osedyfishi i

- Per kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë: Kontraten e bashkimit te operatoreve dhe prokuren e posacme te deklaruar ne fazen e tenderimit.

1. Operatoret ekonomik pjesemarrës duhet te paraqesim vertetim per shlyerjen e detyrimeve vendore per vitin 2023

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 40, pika 7, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Pasi institucioni yne duhet te sigurohet se cdo operator ushtron aktivitetin konform te gjitha dispozitave ligjor ne fuqi dhe eshte korrekt me pagimin e cdo detyrimi financiar qe ka.

Ofertuesi : Për efekt të kryerjes së punimeve në tërësi, ofertuesi duhet të ketë ne listpagesat e 3 muajve te fundit (Tetor 2023 – Dhjetor 2023) stafin e teknik te meposhtem:

Nje inxhinier ndërtimi, Dy inxhinier elektrik (Te jene te certifikuar me kategoria V), Nje Ing.Mjedisi (Me certifikim per auditim mjedisor), Nje Inxhinier Topograf.

- Inxhinieret e mesiperme duhet te jene te pajisur me kontrate pune te vlefshme, diplome, Cv, Libreze Pune.
- Shoqeria duhet te kete ne stafin e saj, te pakten, 10 punonjes elektrikista te certifikuar nga IQT (Inspektoriati Qendror Teknik) apo nga organet e pavarura te njohura, ku minimalisht 3 te jene te pajisur me kategorin e III elektrike.
- Ofertuesi duhet te kete ne stafin e tij ne listpagese ose te kontraktuar 8 manovratore makinerish per te cilet te paraqiten deshmite perkatese.
- Ofertuesi duhet te kete ne stafin e tij ne listpagese 1 teknik ndertimi, te shoqeruar me diplome te shkolles se mesme.
- Ofertuesi duhet te kete ne stafin e tij ne listpagese 1 Saldator, te shoqeruar me diplome te shkolles se mesme.
- Ofertuesi duhet te kete ne stafin e tij ne listpagese nje punonjes te certifikuar per dhenien e ndihmes se pare (Nga Kryqi i Kuq Shqiptar ose ekuivalent).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 41, pika 4/c dhe 4/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Pasi institucioni yne duhet te sigurohet se cdo operator ushtron aktivitetin konform te gjitha dispozitave ligjor ne fuqi dhe eshte korrekt me pagimin e cdo detyrimi financiar qe ka dhe te kete te punesuar keto specialiste te domosdoshem per te kryer sherbimet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 41, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Autoriteti Kontraktor vlereson se duhet te paraqiten mostrat perkatese pasi eshte e nevojshme qe ato te jene ne perputhje me specifikimet teknike.

Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që kanë dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës(shtojca 9)

Disponimi ose mundësia e sigurt e disponimit në paisjet/kapacitete te mëposhtme teknike, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës:

| Nr. | Pershkrimi i Automjetit | Sasia |
|------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------|
| 1. | Eskavator me goma | 1 copë |
| 2. | Kamion transportues me kapacitet mbartes minimal 20 ton | 2 copë |
| 3 | Autobetoniere | 1 copë |
| 4. | Fadroma | 2 copë |
| 5 | Kamioncine | 2 copë |
| 6 | Automjet vinc kulle per punime ne lartesi | 1 copë |
| 7. | Kenotron per kablo, Megaometer 500 V, Megaometer Meger 2500-5000 V dhe aksesoret e nevojshme per kryerjen e matjeve dhe testeve te aparaturave elektrike) | 1 copë |
| 8. | Kambaleca per mbajtjen e barabaneve te kabllove | 2 copë |
| 9. | Pajisje terheqese per percjellesat (me dinamometer, Paranga karukla) | 2 copë |
| 10. | Terrameter per matjen e rezistences se tokezimit | 1 copë |
| 11 | Kambaleca per ngjitje ne shtylle | 10 cope |
| 12. | Autovinc me kapacitet mbartes minimal 16 ton | 1 cope |
| 13 | Prerese Asfalti | 1 cope |
| 14 | Autobitumatrice | 1 cope |
| 15 | Rrul | 1 cope |
| 16 | Asfaltoshtruese | 1 cope |

1. Per mjetet qe shenohen ne rregjistra publike duhet te paraqitet dokument qe verteton pronesine e mjetit (certifikate pronesie), dokument qe verteton rregjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), Certifikata e Kontrollit Teknik SGS si dhe Siguracionin e Mjetit (Polica e Sigurimit); te vlefshme. Per mjetet e siguruara me qera,te paraqiten dokumentet qe vertetojne Rregjistrimin e tij, plus Certifikaten e Kontrollit Teknik (SGS) dhe siguracionin e mjetit te vlefshme. Keto dokumente duhet te shoqerohen me Kontraten perkatese te qerese / furnizimit, e vlefshme kjo per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates objekt i ketij prokurimi. Per mjetet dhe pajisjet e tjera qe nuk jane te shenuara ne rregjistra publike duhet te paraqitet kontrate noteriale e blerjes /fature tatimore / dokument zhdoganimi te mjetit .
2. Per pajisjet ne pronesi shoqerohen me akt pronesie origjinal ose fotokopj e te noterizuar (kontrata shit blerje, kontrata dhurimi, fatura tatimore shitje, deklarate zhdoganimi) te vlefshme.
3. Për të konfirmuar disponibilitetin e mjeteve të marra me qira të paraqiten kontratë noteriale qiraje/huapërdorje me emër objekti dhe me afat të përcaktuar të cilat do të jenë në dispozicion deri në realizimin e punimeve; dhe/ose kontratë noteriale qiraje/huapërdorje pa afat të përcaktuar por të jenë të shoqëruara detyrimisht me mandat pagesat sipas parashikimit ligjor për secilin nga automjetet dhe/ose makineritë/pajisjet e marra me qira (me perjashtim te rasteve kur kontrata e qerese I fillon efektet ne nje moment te dyte pas zhvillimit te procedures se prokurimit)

Kriteri konsiderohet i permbyshur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën në rastin kur OE shpallet fitues, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

-Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesin kontratë furnizimi noteriale me Inerte, Zhavor dhe Rere . Furnizuesi duhet të jetë i pajisur me Licence QKL III.1.B “Leje mjedisore tipi B, për aktivitetin Impiant Franksionim Inertesh” , Licence QKL III.1.A “Autorizim mjedisor për aktivitetin Linje Prodhim Betoni”

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 41, pika 5/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Autoriteti vlereson se është e domosdoshme posedimi i këtyre mjeteve për të bërë të mundur realizimin e zerave të punimeve. Pasi çdo mjet është në përputhje me llojin e punës që do kryhet sipas preventivit përkatës.

6-Subjektiduhetjeteipajisur me :

- Çertifikatat e cilësisë sipas Standartit **ISO 9001:2015 (për sistemin e menaxhimit të cilësisë)**, e vlefshme,
- Çertifikatat e cilësisë sipas Standartit **ISO 14001:2015 (për sistemin e menaxhimit të mjedisit)**, e vlefshme,
- Çertifikatat e cilësisë sipas Standartit **OHSAS 18001:2007 (për sistemin e**

menaxhimit te shendetit dhe sigurise ne pune), ose cetifikaten ISO 45001-2018
ekuivalente,e vlefshme,

- Çertifikatat e cilësisë sipas Standartit **ISO 50001: 2008 (per menaxhimin e sistemit te energjise), e vlefshme,**

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 41, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Autoriteti Kontraktor vlereson se cdo subjekt pjesemarres duhet te jete i certifikuar per te garntuar edhe cilesine e produkteve objekt prokurimi.

NJESIA E PROKURIMIT